



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.09.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2025-14 për z.Ekrem Mustafa-Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajit, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-2025-14, për Zyrtarin e lartë, z.Ekrem Mustafa-Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajit dhe njëkohësisht person i autorizuar në disa biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Ekrem Mustafa fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Mustafa është deklaruar do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara duke inicuar procedurën e shuarjes së biznesit, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Mustafa ka kaluar një afat për të kryer këto veprime të nevojshme, prandaj me datën 17.09.2014 Agjencia kundër Korrupsionit i ka bërë edhe shkresën e dytë, që quhet "Paralajmëruese", me të cilën nga ztr. Mustafa është kërkuar që brenda afatit të caktuar të kryej

këto ndryshime në biznes, në të kundërtën Agjencia kundër korrupsionit do të procedoj rastin konform nenit 18 paragrafi 8.

Me datën 22.09.2014, z.Mustafa në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresat zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), "Informata mbi bizneset", (DPK-03-3315-14 dhe DPK-03-3316/14), në të cilat shihet se bizneset private, "D.Construction Sarl – Dega në Kosovë" dhe Veprimtaria e Pavarur Bujqësore "Blegtoria", tanimë, në mënyrë vullnetare janë shuar si biznese.

Tani, z. Mustafa, ushtron vetëm funksionin e Këshilltar Komunal në Komunën e Ferizajit.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

